



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PER KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE
OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

THIRRJE PËR APLIKIM
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË KOMUNAVE:
PRISHTINË, PRIZREN DHE MITROVICË

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SPECIAL “ZONAT RURALE MË PAK TË ZHVILLUARA” MBËSHTETJE PRODHIMIT TË QUMËSHITIT DHE MISHIT (LOPËT QUMËSHTORE, DHENTË DHE DHITË)

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e ndihmës financiare/grantit për investime në ferma në kuadër të programin special “Zonat rurale më pak të zhvilluara” - **Mbështetje prodhimit të qumështit dhe mishit (lopët qumështore, dhentë dhe dhitë).**

II. Përfituesit e mundshëm

Përfitues të kësaj mase mund të janë personat fizik ose juridik të cilët duhet të jenë:

- Banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- Të regjistruar si fermerë në Regjistrat e Sektorit për Identifikim dhe Regjistrim të kafshëve (I&R) pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV);
- Të jenë të regjistruar në regjistrin e fermës.

III. Kriteret e pranueshmërisë

Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit:

- a) Të jenë të regjistruar si fermerë në Regjistrat e Sektorit për Identifikim dhe Regjistrim të Kafshëve (I&R) pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV).
- b) Aplikuesit duhet të kenë lopë ose dele dhe dhi të shënjuar me matrikuj të Republikës së Kosovës dhe të posedojnë Listën e verifikimit të tyre për çdo krerë të lëshuar nga AUV.

- c) Kafshët e importuara nga shtetet e BE-së duhet të regjistrohen në Listën e verifikimit të gjedhëve respektivisht ripërtpësve të imtë në AUV, por mund të mbajnë matricat e vendeve të BE-së.
- d) Të kenë së paku:
 - d.1 **5 lopë qumështore,**
 - d.2 **50 dele mjelëse dhe**
 - d.3 **30 dhi mjelëse.**
- e) Dëshmi për posedimin e të paktën 0.5 ha të tokës bujqësore (ara, livadhe dhe kullota) për çdo kokë lope, referoju pikës d.1.
- f) ose 0,05 ha për kokë deleje apo dhie referoju pikës d.2 dhe d.3. Toka mund të jetë në pronësi ose e marrë me qira për të paktën 3 vjet.

IV Shtrirja gjeografike

Programi përfshin komunat: Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren.

7. Investimet e pranueshme për lopë qumështore janë:

7.1. Ndërtimi i stallës së re për lopë qumështore

Stalla duhet të ndërtohet me material të fortë, minimumi i sipërfaqes së ndërtuar duhet të jetë **80 m²** për mbajtjen e kafshëve në tipin e lidhur me infrastrukturë të brendshme si në vijim:

- Grazhdi,
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe ujëpirset,
- Vendqëndrimet për lopë,
- Vendqëndrimet për viça,
- Dyert ballore dhe anësore (sipas nevojës),
- Dritaret me pozicion horizontal,
- Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës,
- Kanali për bartjen e ujërave të ndotura nga ferma.

7.2 Ndërtimi ose renovimi i dhomës së qumështit me pajisje

- Dhoma e qumështit/bulmetit, ndërtimi i ri, sipërfaqe minimale **12m²**, me hyrje të veçantë nga hyrja në stallë.
- Makinë Mjelëse lëvizëse.
- Ndërtimi apo renovimi i dhomës së qumështit/bulmetit që përfshinë:
 - a) dyshtet e shtruar me pllaka,
 - b) mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m.,
 - c) furnizim me ujë të pijes dhe
 - d) sistem të kanalizimit.

7.3 Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:

7.3.1 Deponi e plehut të ngurtë të stallës (2m³ për Njësi blegtorale);

7.3.2 Deponi për silazh, sistemi horizontal (3m³ për Njësi blegtorale);

7.3.3 Deponi për ushqim voluminoz, hangarë (minimumi 270 m³).

8. Investimet e pranueshme për ripërtypësit e imtë-dele:

8.1. Ndërtimi i stallës së re për dele

Stalla duhet të ndërtohet me material të fortë, minimumi i sipërfaqes së ndërtuar duhet të jetë **150m²** për mbajtjen e kafshëve (deleve) me infrastrukturë të brendshme si në vijim:

- Grazhdet;
- Sistemi për furnizim me ujë dhe ujëpirëset;
- Vendqëndrimet për kafshë të rritura, bokset e ndara me konstruksion të lehtë;
- Vendqëndrimet për qengja;
- Dyert ballore dhe anësore (sipas nevojës);
- Dritaret me pozicion horizontal.

8.2 Ndërtimi ose renovimi i dhomës së qumështit/bulmetit:

- Dhoma e qumështit/bulmetit, ndërtimi i ri, sipërfaqe minimale **12m²**, me hyrje të veçantë nga hyrja në stallë;
- Ndërtimi apo renovimi i dhomës së qumështit/bulmetit që përfshinë:
 - a) dyshtet e shtruar me pllaka,
 - b) mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m.,
 - c) furnizim me ujë të pijes dhe
 - d) sistem të kanalizimit.

8.3. Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:

- Deponi për ushqim voluminoz, hangarë me kapacitet së paku 250m³.

9. Investimet e pranueshme për ripërtypësit e imtë-dhi:

9.1. Ndërtimi i stallës së re për dhi

Stalla duhet të ndërtohet me material të fortë, minimumi i sipërfaqes së ndërtuar duhet të jetë **100m²** për mbajtjen e kafshëve (dhive) me infrastrukturë të brendshme, si në vijim:

- Grazhdet;
- Sistemi për furnizim me ujë dhe ujëpirëset;
- Vendqëndrimet për kafshë të rritura, bokset e ndara me konstruksion të lehtë;
- Vendqëndrimet për keca;
- Dyert ballore dhe anësore (sipas nevojës);
- Dritaret me pozicion horizontal.

9.2 Ndërtimi ose renovimi i dhomës së qumështit/bulmetit:

- Dhoma e qumështit/bulmetit, ndërtimi i ri, sipërfaqe minimale **12m²**, me hyrje të veçantë nga hyrja në stallë;
- Ndërtimi apo renovimi i dhomës së qumështit/bulmetit që përfshinë:
 - a) dyshtet e shtruar me pllaka,
 - b) mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m.,

- c) furnizim më ujë të pijes,
- d) sistem të kanalizimit.

9.3. Përmirësimi i infrastruktures përcjellëse në fermë:

- Deponi për ushqim voluminoz, hangarë me kapacitet së paku 200m³.

10. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për nënmasën

- Projektet me vlerë deri 20,000 euro duhet të dorëzojnë projekt-propozimin i cili përmban: përshkrimin e gjendjes ekzistuese në fermë, përshkrimin e investimeve të nevojshme dhe koston e investimeve;
- Të dorëzohet projekt propozimi dhe një plan biznesi i punuar sipas udhëzimeve të MBPZHR (për projektet me vlere mbi 20,000)
 - Dëshmia kadastrale e tokës bujqësore (ara, livadhe dhe kullota) në pronësi ose një kopje e kontratës për qiramarrje të tokës bujqësore për të paktën tre vjet pas aplikimit;
 - Kopja e kontratës për dorëzimin e qumështit tek përpunuesi (nëse e posedon);
 - Dëshmi për anëtarësimin në shoqatën e prodhuesve të qumështit për aplikuesit për stallë të lopëve, respektivisht shoqatën e dhenarëve për aplikuesit për stallë të dhenve/dhive (nëse ai/ajo është anëtar i shoqatës);
 - Kopjen e listës së verifikimit të bagëtive të lëshuar nga Sektori për Identifikimin dhe Regjistrimin në AUV për të gjitha kafshët.

11. Niveli i mbështetjes

11.1 Për lopët qumështore:

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për ndërtimin e stallës së re sipas pikës 7.1 është 10.000 euro.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 7.2 është 5000 euro.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 7.3.1, 7.3.2 dhe 7.3.3 (për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse) është 4000 euro, për secilin pozicion.

11.2 Për dele:

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për ndërtimin e stallës së re sipas pikës 8.1 është 15.000 euro.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 8.2 është 5000 euro.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 8.3 (për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse) është 4000 euro.

11.3 Për dhi

- 12. Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për ndërtimin e stallës së re sipas pikës 9.1 është 10.000 euro.
- 13. Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 9.2 është 5000 euro.
- 14. Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 9.3 (për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse) është 4000 euro.

Për të gjitha investimet intensiteti i ndihmës publike është **75 %** i shpenzimeve të pranueshme. Çdo shpenzim tjetër përtej kufijve të pranueshëm do të konsiderohet si jo i pranueshëm.

15. Koha dhe mënyra e marrjes së formularëve për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 30 ditë nga data e publikimit.

Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita e publikimit të thirrjes për aplikim.

Aplikuesit duhet të vijnë në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë (AZHB) në Prishtinë, adresa: rruga “Nazim Gafurri”, nr. 23 dhe të marrë dokumentet e nevojshme për të aplikuar.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë (AZHB), çdo dit pune nga ora 10:00-15:00.

MBPZHR			
Nga e hëna deri të premten nga ora 10:00-15:00			e-maili
1	Agjencioni i Zhvillimit Bujqësor		038 211 967
